



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

NJOFTIM

Universiteti i Prishtinës në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit akademik 2021/22, bazuar në propozimet e njësive akademike, planifikon të shpall konkurs për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore – baçelor.

Programet studimore të hijezuara me ngjyrë të verdhë aktualisht janë në proces të akreditimit, përkatësisht ri-akreditimit, ndërsa programet tjera të listuara kanë akreditim valid.

Konkursi për pranimin e studentëve do të shpallet konform vendimeve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë për akreditimin e programeve dhe pas miratimit të numrit të studentëve nga MASHTI.

Pas pranimit të vendimeve të lartpërmendura konkursi do të publikohet në të gjitha platformat elektronike të Universitetit të Prishtinës.

I. FAKULTETI FILOZOFIK

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **610** studentë në departamentet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Filozofik	506	72	13	13	6	610
Departamenti Filozofi	83	12	2	2	1	100
Programi Filozofi	83	12	2	2	1	100
Departamenti Punë Sociale	41	6	1	1	1	50
Programi Punë Sociale	41	6	1	1	1	50
Departamenti Histori	101	14	2	2	1	120
Programi Histori	101	14	2	2	1	120
Departamenti Shkenca Politike	83	12	2	2	1	100
Programi Shkenca Politike	83	12	2	2	1	100
Departamenti Sociologji	83	12	2	2	1	100
Programi Sociologji	83	12	2	2	1	100
Departamenti Psikologji	83	12	2	2	1	100
Programi Psikologji	83	12	2	2	1	100
Departamenti i Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore	32	4	2	2	0	40
Profili Antropologji Kulturore	16	2	1	1	0	20
Profili Arkeologji	16	2	1	1	0	20

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e mëmit të ngushtë profesional të degëve mësimore të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Filozofisë nga Filozofia dhe Sociologjia;
- Në Departamentin e Punës Sociale nga Edukata Qytetare, Psikologjia dhe Sociologjia;
- Në Departamentin e Historisë nga Historia e botës, Historia e popullit shqiptar dhe Edukata qytetare;
- Në Departamentin e Shkencave Politike nga Sociologjia, Filozofia, Historia dhe Edukata qytetare;
- Në Departamentin e Sociologjisë nga Sociologjia dhe Filozofia;
- Në Departamentin e Antropologjisë nga Historia, Letërsia dhe Sociologjia.
- Në Departamentin e Psikologjisë nga Psikologjia, Filozofia dhe Verifikimi i aftësive të përgjithshme për studime.

II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **570** studentë të rregullt dhe atë në departamentet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
SHMN	473	67	11	11	8	570
Departamenti i Matematikës	150	21	3	3	3	180
Programi Matematikë	50	7	1	1	1	60
Programi Shkencat Kompjuterike	50	7	1	1	1	60
Programi Matematikë financiare në banka dhe sigurime	50	7	1	1	1	60
Departamenti i Fizikës	65	10	2	2	1	80
Programi Fizikë	65	10	2	2	1	80
Departamenti i Kimisë	100	14	2	2	2	120
Programi Kimi	50	7	1	1	1	60
Programi Kimi Inxhinierike	50	7	1	1	1	60
Departamenti i Biologjisë	99	14	3	3	1	120
Programi Biologji	61	9	2	2	1	75
Programi Ekologji-Mbrojtje e mjedisit	38	5	1	1	0	45
Departamenti i Gjeografisë	59	8	1	1	1	70
Programi Gjeografi	59	8	1	1	1	70

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e mëmit të ngushtë profesional të departamentit përkatës të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Matematikës nga Matematika;
- Në Departamentin e Fizikës nga Fizika dhe Matematika;
- Në Departamentin e Kimisë nga Kimia, Fizika dhe Matematika;
- Në Departamentin e Biologjisë nga Biologjia dhe Kimia;
- Në Departamentin e Gjeografisë nga Gjeografia.

Në testet e provimit pranues të cilat kanë detyra, krahas qarkimit të përgjigjes së saktë, duhet të ofrohet edhe zgjidhja e detyrës.

III. FAKULTETI I FILOLOGJISË

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **740** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Filologjik	621	83	14	14	8	740
Programi Gjuhë Shqipe	50	7	1	1	1	60
Programi Letërsi Shqipe	65	10	2	2	1	80
Programi Gjuhë dhe Letërsi Angleze	107	16	3	3	1	130
Programi Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	101	14	2	2	1	120
Programi Gjuhë dhe Letërsi Frënge	59	8	1	1	1	70
Programi Orientalistikë	24	4	1	1	0	30
Programi Gjuhë dhe Letërsi Turke	41	6	1	1	1	50
Programi Gazetari	124	18	3	3	2	150
Programi Ballkanistikë	50					50

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të departamentit përkatëse të fakultetit:

- Në Programin e Gjuhës Shqipe nga Gjuha shqipe (me shkrim);
 - Në Programin e Letërsisë Shqipe nga Letërsia shqipe (me shkrim);
 - Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze nga Gjuha angleze (me shkrim);
 - Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane nga Gjuha gjermane (me shkrim);
 - Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Frënge nga Gjuha frënge (me shkrim);
 - Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Turke nga Gjuha turke (me shkrim);
 - Në Programin e Orientalistikës provimi pranues mbahet në formë testi nga këto lëmi: Gjuhë turke dhe arabe (njohuri elementare), Qytetërim islam, kulturë orientale (me shkrim);
 - Në Programin e Gazetarisë provimi pranues mbahet në formë testi nga këto lëmi: Gjuhë shqipe, Letërsi shqipe, Qytetërim shqiptar, Qytetërim botëror, dhe Ese.
 - Provimi pranues në Ballkanistikë mbahet me shkrim nga gjuha amtare e kandidatit/es dhe nga gjuha ballkanike, për t'u përcaktuar saktë niveli gjuhësor i kandidatit/es.
- Për kandidatët shqiptarë, gjuhë ballkanike është njëra nga gjuhët: BSKM (boshnjake, serbe, kroate, malazeze), maqedone, bullgare, greke, rumune ose turke, ndërkaq për kandidatët joshqiptarë, gjuhë ballkanike në këtë program është gjuha shqipe.

IV. FAKULTETI JURIDIK

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **800** studentë të rregullt.

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Juridik	664	96	16	16	8	800

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Fillet e së Drejtës, E Drejta Kushtetuese dhe Gjuhë Shqipe.

V. FAKULTETI EKONOMIK

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **1250** studentë të rregullt, dhe atë në departamentet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Ekonomik	1036	150	25	25	14	1250
Departamenti Banka dhe financa	249	36	6	6	3	300
Programi Banka dhe financa	249	36	6	6	3	300
Departamenti Menaxhment	290	42	7	7	4	350
Programi Menaxhment	290	42	7	7	4	350
Departamenti Marketing	166	24	4	4	2	200
Programi Marketing	166	24	4	4	2	200
Departamenti Ekonomiks	166	24	4	4	2	200
Programi Ekonomiks	166	24	4	4	2	200
Departamenti i Kontabilitetit	124	18	3	3	2	150
Programi i Kontabilitetit	124	18	3	3	2	150
Departamenti Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment (Gjuhë Angleze)(BSc)	41	6	1	1	1	50
Programi Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment (Gjuhë Angleze)(BSc)	41	6	1	1	1	50

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për departamentet në gjuhën shqipe do të mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi dhe Matematikë.
Provimi pranues për programin Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment (Gjuhë Angleze)(BSc), do të mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi, Matematikë dhe Gjuhë angleze.

VI. FAKULTETI I NDËRTIMTARISË

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **250** studentë të rregullt dhe atë sipas departamenteve si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Fakulteti i Ndërtimtarisë	217	31	5	5	2	260
Departamenti i Konstruksioneve	101	14	2	2	1	120
Programi Konstruktiv	101	14	2	2	1	120
Departamenti i Hidroteknikës	33	5	1	1	0	40
Programi Hidroteknikë	33	5	1	1	0	40
Departamenti i Gjeodezisë	50	7	1	1	1	60
Programi Gjeodezi	41	6	1	1	1	60
Departamenti i Inxhinierisë së Mjedisit	33	5	1	1	0	40
Programi Inxhinieri e Ambientit	33	5	1	1	0	40

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues do të mbahet nga lënda: Matematikë.

Për t'u pranuar, kandidati duhet të arrijë minimum 40% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues, përveç kandidatëve që i takojnë kategorisë si në paragrafët 2, 3 dhe 4 të pikës I të këtij konkursi, të cilët duhet të arrijnë minimumi 30% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues.

VII. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **430** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
FIEK	355	52	9	9	5	430
Programi i Inxhinierisë Kompjuterike dhe Softuerike	124	18	3	3	2	150
Programi Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë	101	14	2	2	1	120
Programi Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	65	10	2	2	1	80
Programi Elektroenergjetikë	65	10	2	2	1	80

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues do të mbahet nga lënda: Matematikë.

VIII. FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **440** studentë të rregullt dhe atë sipas programeve si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
FIM	361	54	10	10	5	440
Programi Prodhimtari dhe Automatizim dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment	74	11	2	2	1	90
Programi Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtëritshme	74	11	2	2	1	90
Programi Komunikacion dhe transport	74	11	2	2	1	90
Programi Mekatronikë	74	11	2	2	1	90
Programi Dizajn Inxhinierik dhe Automjete	65	10	2	2	1	80

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lënda: Matematikë.

IX. FAKULTETI I MJEKËSISË

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **420** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Mjekësisë	348	50	8	8	6	420
Programi Mjekësi e Përgjithshme	124	18	3	3	2	150
Programi Stomatologji	59	8	1	1	1	70
Programi Farmaci	41	6	1	1	1	50
Programi Fizioterapi	41	6	1	1	1	50
Programi Infermieri	83	12	2	2	1	100

Kandidatët të cilët aplikojnë për programet e studimit: Fizioterapi dhe Infermieri duhet të kenë të kryer shkollën e mesme të Mjekësisë.

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për të gjitha degët e Fakultetit të Mjekësisë mbahet nga lëndët: Kimi dhe Biologji.

X. FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **248** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Fakulteti i Arteve	211	27	4	4	2	248
<i>Departamenti i Arteve të Bukura</i>	67	8	2	2	1	80
<i>Programi Bachelor i Arteve Vizuale</i>	67	8	2	2	1	80
Profili Pikturë	15	2	1	1	1	20
Profili Skulpturë	9	1	0	0	0	10
Profili Grafikë	9	1	0	0	0	10
Profili Arti Konceptual dhe Mediet e Reja	9	1	0	0	0	10
Profili Dizajn i Inovacioneve	9	1	0	0	0	10
Profili Dizajn i Komunikimit	9	1	0	0	0	10
Profili Ilustrim dhe Vizatim	7	1	1	1	0	10
<i>Departamenti i Arteve Muzikore</i>	97	11	1	1	0	110
<i>Programi Bachelor i Muzikës</i>	33	5	1	1	0	40
Profili Pedagogji e përgjithshme muzikore	31	5	1	1	0	38
Profili Kompozim	2	0	0	0	0	2

Programi Bachelor i Muzikës në Performim	64	6	0	0	0	70
Profili Solo këndim	4	1	0	0	0	5
Profili Dirigjim	2	0	0	0	0	2
Profili Piano	14	2	0	0	0	16
Profili instrumentet me harqe dhe tela	16	1	0	0	0	17
Moduli Violinë	3	1	0	0	0	4
Moduli Violë	4	0	0	0	0	4
Moduli Violonçelo	3	0	0	0	0	3
Moduli Kontrabas	3	0	0	0	0	3
Moduli Kitarë	3	0	0	0	0	3
Profili instrumentet frymore	28	2	0	0	0	30
Moduli Flaut	5	1	0	0	0	6
Moduli Obo	3	0	0	0	0	3
Moduli Klarinetë	3	1	0	0	0	4
Moduli Trombon	3	0	0	0	0	3
Moduli Fagot	3	0	0	0	0	3
Moduli Korne	3	0	0	0	0	3
Moduli Trompete	3	0	0	0	0	3
Moduli Saksofon	3	0	0	0	0	3
Moduli Tubë	2	0	0	0	0	2
Departamenti i Arteve Dramatike	47	8	1	1	1	60
Programi i Arteve Dramatike	47	8	1	1	1	60
Profili Aktrim	8	1	1	0	0	10
Profili Dramaturgjii dhe Skenar filmi	6	1	0	1	0	8
Profili Regji Filmi dhe Televizioni	5	1	0	0	0	6
Profili Regji Teatri	5	1	0	0	0	6
Profili Dizajn Skene dhe Kostumografi	9	1	0	0	0	10
Profili Kamerë dhe Montazhë	8	1	0	0	1	10
Profili Produksion	8	2	0	0	0	10

KUSHTET E REGJISTRIMIT

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në Fakultetin e Arteve duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

NË DEPARTAMENTIN E ARTEVE TË BUKURA

Profili: Pikturë

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e vizatimit duke realizuar portret, figurë sipas modelit përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e pikturës përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portfolios i cili duhet të jetë si vijon: (Verzioni fizik në formatin A3 dhe verzioni soft në CD) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e arteve vizuale në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, piktura dhe skica ideore).
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Profili: Skulpturë

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen testimin nga njohuritë e vizatimit duke realizuar portret, figurë sipas modelit përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen testimin nga njohuritë e skulpturës përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Verzioni fizik në formatin A3 dhe verzioni soft në CD) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e arteve vizuale në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, skulptura, instalacione dhe skica ideore).
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Profili: Grafikë

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen testimin nga njohuritë e vizatimit duke realizuar portret, figurë sipas modelit përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen testimin nga njohuritë e grafikës duke realizuar një detyre kreative përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Verzioni fizik në formatin A3 dhe verzioni soft në CD) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e arteve vizuale në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, skica për grafikë dhe skica ideore).
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Profili: Arti konceptual dhe mediat e reja

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen testimin nga njohuritë e artit konceptual dhe mediave të reja përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e dytë

- Kandidatët duhet të shkruajnë një ese prej 400 fjalësh, përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Verzioni fizik në formatin A3 dhe verzioni soft në CD) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e mediave të reja në të cilat mund të përfshijnë (fotografi, video, instalacione, intervenime artistike apo skicka ideore).
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Profili: Dizajni i inovacioneve

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen testimin nga njohuritë e dizajnit dhe inovacioneve duke realizuar një detyre kreative përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike nga fusha e dizajnit të produkteve, dizajnit të modës, marketingut në rrjete sociale dhe fotografisë.
- Kandidatët duhet të shkruajnë një ese prej 400 fjalësh, përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen testimin në softwerët e Adobe Suite përmes realizimit të një detyre kreative.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Verzioni fizik në formatin A3 dhe verzioni soft në CD) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e Dizajnit në të cilat mund të përfshijnë (dizjane të produkteve, dizajne të modës, animacione, fotografi, poster dhe punime të tjera kreative).
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Profili: Dizajni i komunikimit

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e dizajnit duke realizuar një detyre kreative përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike në fushën e ilustrimit, mediave dixhitale dhe komunikimit vizual.
- Kandidatët duhet të shkruajnë një ese prej 400 fjalësh, përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen testimit në softwerët e Adobe Suite përmes realizimit të një detyre kreative.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Verzioni fizik në formatin A3 dhe verzioni soft në CD) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e Dizajnit në të cilat mund të përfshijnë (ilustrime, skica ideore, dizajn të web-faqes, video dhe punime të tjera kreative).
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t’iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Profili: Ilustrim dhe vizatim

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e vizatimit duke realizuar portret, figurë sipas modelit përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e ilustrimit duke realizuar një detyre kreative përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Verzioni fizik në formatin A3 dhe verzioni soft në CD) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e arteve vizuale në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, ilustrime dhe skica ideore).
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t’iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

NË DEPARTAMENTIN E ARTEVE MUZIKORE

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në nivelin baçelor në Fakultetin e Arteve, respektivisht në profilet e Departamentit të Muzikës, duhet t’i plotësojnë edhe këto kushte:

-Duhet të ketë të përfunduar shkollën e mesme të Muzikës në instrumentin përkatës apo drejtimin përkatës.

BACHELOR I MUZIKËS NË PËRFORMIM

Profili: PIANO

- Provim nga lënda PIANO - (a) J. S. Bach - 1 Prelud dhe Fugë nga WTC b) 1 Vepër virtuozë; c) 1 Sonatë klasike (një kohë); d) 1 Vepër madhore romantike;
- Provim nga lënda: SOLFEZH;
- Provim nga lënda TEORI E MUZIKËS;

Profili: INSTRUMENTET ME HAROE DHE TELA

- Provim nga instrumenti harkor përkatës - (a) J. S. Bach - 1 Kohë nga Suita / Partita; b)1 Koncert (një kohë); c) 1 Sonatë (një kohë); d) 1 Pjesë cantilene;
- **Moduli: KITARË-** a) 2 kohë nga suitat e Bach-ut (nga suitat për çello ose flaut); b) F. SOR – 1 etydë nga op.6.dhe 29; c) 1 etydë përzgjedhje; d) 1 vepër ciklike;
- Provim nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lënda: TEORI e MUZIKËS

Profili: INSTRUMENTET FRYMORE

- Provim nga lënda e instrumenti frymor përkatës- (a) 1 Koncert (komplet); b) 1 Sonatë (komplet); c) 1Pjesë virtuozë;)
- Provimi nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lënda: TEORI e MUZIKËS

Profili: SOLO KËNDIM

- Provim nga lënda: SOLO KËNDIM -(a) 2 Arie (nga repertori operistik); b) 2 Këngë solo (në cilëndo gjuhë);
- Provim nga lëndët: SOLFEZH - TEORI e MUZIKËS
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

Profili: DIRIGJIM

- Dirigjim i një vepre për ansambël kamertal, orkestër apo për ndonjë formacion koral; (dirigjimi mund të realizohet me korepetitor ose me incizim në DVD). Incizimi duhet të fokusohet në fytyrë (profil) dhe në lëvizjet e duarve të kandidatit, si dhe mundesisht edhe të një pjese të orkestrës. Incizimi duhet të dorëzohet së paku dy ditë para provimit.
- Provim nga lënda: **SOLFEZH**
- Provim nga lëndët: **HARMONI**
- Provim nga lënda: **PIANO OBLIGAT**

BACHELOR I MUZIKËS

Profili: KOMPOZIM

- Prezantimi i 3 kompozimeve të dorëzuara;
- Provim nga lënda: **SOLFEZH**
- Provim nga lëndët: **HARMONI - POLIFONI**
- Provim nga lënda: **PIANO OBLIGAT**

Profili: PEDAGOGJI E PËRGJITHSHME MUZIKORE

- Provim nga lënda: **SOLFEZH**
- Provim nga lënda: **HARMONI**
- Provim nga lënda: **PIANO OBLIGAT**

NË DEPARTAMENTIN E ARTEVE DRAMATIKE

Programi i Arteve Dramatike

Për verifikimin e aftësive të veçanta, kandidatët do të japin këto provime:

Profili Aktrim

Pjesa e parë e programi eliminues:

- Recitim i një poezie (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Monolog dramaturgjia e autorëve- dramaturgëve botërorë dhe kombëtarë (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Tregim i shkurtër popullor (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një këngë;
- Një imitim;

Kandidati është i obliguar që t'i mësojë përmendësh dhe t'i përgatisë detyrat. Komisioni, pas programit të shfaqur, mund t'i shtrojë kandidatit edhe detyra plotësuese (improvizime), për të fituar bindje sa më të plotë për aftësitë e kandidatit.

Pjesa e dytë e programit eliminues:

- Puna me mësimdhënës të caktuar,
- Verifikimi përfundimtar i aftësive.
- Të gjithë aplikantët luten të sjellin fotografi "bust" në ditën e aplikimit.

Profili Regji Teatri

Kandidatët duhet të sjellin një koncept regjisorial për inskenimin e një shfaqje, me skica për hapësirë skenike.

Provimi pranues zhvillohet në dy pjesë:

Pjesa e parë e provimit përbëhet nga vlerësimi i punimeve të sjella dhe vlerësimi i kulturës së përgjithshme të kandidatit, ndërsa pjesa e dytë e provimit pranues (për kandidatët të cilët e kalojnë pjesën e parë të provimit) përbëhet nga inskenimi i një situatë nga një dramë e përcaktuar nga komisioni vlerësues.

Profili i Regji Filmi dhe Televizioni

Kandidatët që konkurrojnë në Regji Filmi duhet t'i nënshtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti dhe kryesisht nga filmi.

Sinopsis me shkrim në temën e dhënë në pjesën e parë të provimit. Tema jepet menjëherë pas testit në provim.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e dytë, i mbrojnë para komisionit punimet e veta.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e tretë, janë të detyruar të gjojnë vetë në temën e dhënë (film tre minutash), të cilin e shfaqin para komisionit në finale.

Profili Dramaturgjia

Hartim me shkrim në temën e lirë,

Dialogu me shkrim në temën e tragjedisë,

Dialogu me shkrim në temën e komedisë,
Testimi me gojë lidhur me njohuritë nga sfera e kulturës së përgjithshme,
Testim me gojë nga fusha e dramaturgjisë.

Profili Dizajn skene dhe Kostumografi

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e vizatimit duke realizuar portret, figurë sipas modelit përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e dizajnit të skenës dhe kostumeve duke realizuar një detyrë kreative përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Verzioni fizik në formatin A3 dhe verzioni soft në CD) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e dizajnit të skenës dhe kostumeve në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, ilustrime, dizajne të skenës, dizajne të kostumeve dhe skica ideore). Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Profili Produksion

Faza e parë

Kandidatët që konkurrojnë në profilin Produksion duhet t'i nënshtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti, filmi, televizioni, radio dhe teatri.

Faza e dytë

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e dytë, do të nënshtrohen provimit, duke shkruar një koncept- ide të një projekti teatror, filmik, televiziv, apo artistik.

Faza e tretë

Kandidatët do të prezantojnë, mbrojnë projektin e tyre në fazën finale, në provim gojor, para komisionit.

Profili Kamerë dhe Montazhë

Kontrolli i plotësimit të kriterëve për programin e studimit për kandidatët “Kamere dhe Montazh filmi” përbëhet nga dy pjesë:

1. Në pjesën e parë, të gjithë kandidatët i nënshtrohen:
 - Bërja e një testi të kulturës së përgjithshme.
 - Një provim me shkrim - analizë (maximum nje faqe) e nje filmi te shkurtër I cili prezentohet nga komisioni vlerësues para kandidatëve rreth kadrimit dhe montazhit.
 - Një provim gojor - një shtjellim i analizës me shkrim, si dhe pyetje nga fusha e Filmit, TV.
2. Pas pjesës së parë, bazuar në rezultatet, Komisioni vendos drejt përzgjedhjes së kandidatëve në një listë të shkurtër, dhe kandidatët e përzgjedhur hyjnë në pjesën e dytë të procesit të përzgjedhjes:
 - Detyra praktike nga fusha e Kamerës dhe Montazhit të Filmit dhe TV, te prezentohet motivi me shkrim para komisionit, ide apo sinopsis ne formë te shkruar jo me I gjatë se një faqe.
 - Pastaj kandidati duhet ta realizoj filmin jo më të gjatë se 3min, pra xhirohet dhe montohet.detyra pastaj vlersohet nga komisioni vlerësues.
 - Një provim gojor ku kandidati do ta mbrojë punimin e tij para komisionit vlersues, nga profili Kamerë dhe Montazh..

Bazuar në rezultatet nga pjesa e parë dhe e dytë të kontrollit, Komisioni rendit dhe zgjedh kandidatët që kanë të drejtën të regjistrohen në profilin Kamere dhe Montazh.

Literatura për provim pranues: Aktrim, Regji Teatri, Regji Filmi, Dramaturgji, Dizajn skene dhe Kostumografi, Produksion, Kamerë dhe Montazhë

- Georg Sodull - "Historia e filmit"
- Abaz Hoxha - "Historia e filmit shqiptar"
- Luis Herman - Skenari i filmit dhe i televizionit
- Jezhi Plazhevski - Gjuha e filmit
- Fadil Hysaj: "Teatrollogji, dramaturgji, regji dhe aktrim"
- Aristoteli: "Poetika"
- Vlladan Shvacov: "Bazat e dramaturgjisë"
- Dr. Nebi Islami: "Historia e dramës kombëtare 1886-1996"
- Dr. Josif Papagjoni: "Komedi që vjen nga skena"

- Eskili: "Orestia"
- Sofokli: Një tragjedi
- Aristofani: Një komedi
- Shekspiri: Një tragjedi
- Moliere: Një komedi
- Dramaturgj nga tradita: Anton Santori, Sami Frashëri, Kristo Floqi etj.
- Dramaturgj bashkëkohore: Anton Pashku, Haqif Mulliqi, Rexhep Qosja, Ymer Shkreli, Flamur Hadri, Ekrem Kryeziu, Nebih Islami, Kasem Terbeshina etj.
- U.Gregor and E.Patalas – „History of Film“
- K.Raisz and G.Millar – „Film Editing“
- Marcel Martin – „The Language of Film“
- Jerzy Plazewski – „Jezik filma“
- Andre Bazin – „What is Cinema“ (I, II, III, IV)

XI.

XII. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **400** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Bujqësisë dhe Veterinarisë	331	48	8	8	5	400
Programi Prodhimtaria bimore	83	12	2	2	1	100
Programi Mjekësi Veterinare	59	8	1	1	1	70
Programi Ekonomia e Bujqësisë	65	10	2	2	1	80
Programi Teknologji ushqimore me bioteknologji	65	10	2	2	1	80
Programi Prodhim Shtazor	59	8	1	1	1	70

PROVIMI PRANUES

Në programin Mjekësi Veterinare, provimi pranues mbahet në lëndët: Kimi dhe Biologji, ndërsa për programet tjera, provimi mbahet në lëndët: Kimi, Biologji dhe Matematikë.

XIII. FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **150** studentë të rregullt:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Edukimi Fizik dhe i Sportit	124	18	3	3	2	150
Meshkuj	83	12	2	2	1	100
Femra	41	6	1	1	1	50

Kandidatët, para se të aplikojnë, duhet të sjellin dëshmi për kontroll të Gjendjes Psiko-Somatike (gjendja shëndetësore, të folurit, të shikuarit, të dëgjuarit, konstruksioni trupor).

Kontrolli mjekësor bëhet në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive, në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve.

PROVIMI PRANUES

Përmbajtja dhe mënyra e dhënies së provimit pranues është:

1. Njohuritë lëvizore (motorike) sportive:
 - Futboll: puna me top-këmbë dhe kokë.
 - Hendboll: pasimet, trehapëshi dhe goditja në portë.
 - Basketboll: pasimi me dy duar, driblimi i topit me një dorë, dyhapëshi dhe gjuajtja në kosh.
 - Volejball: pasimi i topit në çifte me gishtërinj dhe llëra (çekan), gjuajtja dhe pranimi i topit.
2. Aftësitë lëvizore (motorike):
 - Kërcimi nga vendi në gjatësi,
 - Ngritja me forcë në hekur (meshkujt),
 - Përkulje mbi krah (femrat),
 - Shpejtësia në 100 m (matet koha e vrapimit- meshkujt dhe femrat),
 - Bashkërendimi (koordinimi lëvizor),
3. Gjymnastikë sportive - Lëvizjet me trup të lirë: ekuilibri ballor, vertikajla mbi duar, kapërdimi para, rrotullimi anësor në të dy anët ose ylli (meshkujt dhe femrat).
4. Not (demonstrim i një nga teknikat e notit)
5. Agjilitet (T-testi)

Kriteret e poentimit, janë sipas rregullores së brendshme mbi kriteret e veçanta në disiplinat përkatëse.

Sportistët me rezultate të dalluara në sportet ndërkombëtare dhe ata në sportin kosovar poentohen edhe me pikë bonus, sipas kriteve të posaçme të rregullores së brendshme.

Kandidatët janë të obliguar që në ditën e provimit pranues të kenë pajisjet sportive.

XIV. FAKULTETI I EDUKIMIT

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **210** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Edukimit	172	26	5	5	2	210
Departamenti Edukimit Fillor	83	12	2	2	1	100
Programi Edukim Fillor	83	12	2	2	1	100
Departamenti Edukimit Parashkollor	65	10	2	2	1	80
Programi Edukimi në Fëmijëri të Hershme	65	10	2	2	1	80
Departamenti i Pedagogjise	24	4	1	1	0	30
Programi Pedagogji e Përgjithshme	24	4	1	1	0	30

PROVIMI PRANUES

- **Programi Edukim Fillor:** 1. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, 2. Matematikë, 3. Psikologji;
- **Programi Edukimi në Fëmijëri të Hershme :** 1. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, 2. Matematikë, 3. Psikologji;
- **Programi: Pedagogji:** 1. Gjuhë Shqipe, 2. Psikologji, 3. Edukatë Qytetare;

XV. FAKULTETI I ARKITEKTURËS

Në vitin e parë të studimeve planifikon të regjistrojë **150** studentë të rregullt dhe atë në departamentin si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Fakulteti i Arkitekturës	124	18	3	3	2	150
Programi Arkitekturë	124	18	3	3	2	150

Provimi pranues mbahet nga Matematika, Perceptimi i hapësirës dhe Vizatimi i lirë (sllajdi).

Për t`u pranuar, kandidati duhet të arrijë minimum 40% nga piket e parapara për secilën pjesë të provimit pranues.